



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

2007

PLANI I INTEGRUAR I MINISTRISË

Mesazhi i Ministrit

Një nga treguesit e matshëm të reformave dhe performancës së sistemit të drejtësisë mbetet pa dyshim rritja e transparencës dhe aksesit në drejtësi. Në funksion të rikthimit të besimit të shqipëtarëve në sistemin gjyqësor, Ministria e Drejtësisë ka programuar dhe po realizon ndërhyrje konkrete në infrastrukturën ligjore, administrative dhe materiale të sistemit të drejtësisë. Këto ndërhyrje janë materializuar dhe përpunuar në përputhje me programin buxhetor afatmesem 2007-2009, duke u detajuar në masa konkrete të përshkruara për herë të parë në Planin e Integruar të Ministrisë së Drejtësisë, si vijon.

Ju ftoj që, krahas bashkëpunimit të nevojshëm për realizimin e këtij plani, të kontribuoni edhe në përmirësimin e objektivave dhe synimeve të tij.

Ilir Rusmali

Ministër i Drejtësisë

Pasqyra e lëndës

1	Misioni i Ministrisë.....	2
2	Dokumenta strategjike të Ministrisë	3
3	Programet buxhetore të Ministrisë	4
4	Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2007.....	6
5	Plani i Monitorimit të Ministrisë	11
Aneks 1	Projekt-ligjet për tu paraqitur	12
Aneks 2	Rezultate që lidhën me Programin e Qeverisë	15
Aneks 3	Rezultate që lidhën me integrimin Europian	16
Aneks 4	Rezultate që lidhën me anëtarisimin në NATO	17
Aneks 5	Investimet publike	18
Aneks 6	Projekte të ndihmës së huaj	19

1 Misioni i Ministrisë

Ministria e Drejtësisë, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet, ushtron funksione dhe ka në kompetencë hartimin dhe ndjekjen e politikave, përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe ushtrimin e shërbimeve të nevojshme lidhur me sistemin gjyqësor, sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale apo civile, mbikëqyrjen e procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve, sistemin e shërbimeve të lira juridiko-profesionale, bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën civile dhe penale, fushat e tjera të drejtësisë dhe të kompetencës së saj sipas ligjit, si dhe bashkërendimin, harmonizimin dhe reformimin e legjislacionit shqiptar në tërësi.

Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, Ministria e Drejtësisë ka për qëllim të kërkojë respektimin e Kushtetutës, të ligjeve, realizimin dhe mbrojtjen e dinjitetit, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe të kontribuojë në parandalimin e shkeljeve të ligjit, në përputhje dhe në funksion të kërkesave të zhvillimit demokratik dhe të integritetit evropian të Republikës së Shqipërisë.

Ministria e Drejtësisë, në përputhje me ligjin, mbështet, bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë e saj me organet e pushtetit gjyqësor dhe me prokurorinë, duke respektuar parimin e ndarjes së pushteteve dhe të pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe të prokurorisë.

- Ndjek dhe përgjigjet për realizimin e politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e drejtësisë.
- Harton projektet e akteve ligjore e nënligjore në fushën e drejtësisë.
- Kujdeset për funksionimin dhe organizimin e pushtetit gjyqësor.
- Drejton dhe kontrollon administratën gjyqësore.
- Kryen inspektime dhe bën procedimin disiplinor të gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit sipas ligjit.
- Drejton sistemin e ekzekutimit të vendimeve civile dhe të titujve ekzekutivë.
- Mbikëqyr procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve, që realizohet nga Agjencia e Kthimit dhe e Kompensimit të Pronave.
- Drejton veprimtarinë e Qendrës së Publikimeve Zyrtare.
- Drejton shërbimin e unifikuar statistikor në fushën e Drejtësisë.
- Mban regjistrin e gjendjes gjyqësore dhe lëshon certifikatat në bazë të atij regjistrimi.
- Realizon shërbimet juridiko-administrative që sipas ligjit janë në kompetencë të Ministrit të Drejtësisë.
- Kujdeset dhe bashkërendon veprimtaritë për mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshme të të miturve në fushën e drejtësisë, si dhe për edukimin ligjor dhe parandalimin e shkeljeve të ligjit nga të miturit.
- Kujdeset dhe mbështet veprimtaritë për përgatitjen profesionale, aftësimin dhe specializimin e gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve, noterëve dhe juristëve të administratës publike.

Në marrëdhëniet me prokurorinë, Ministria e Drejtësisë ushtron kontroll sipas ligjit mbi organin e prokurorisë dhe mbi respektimin e parimeve të drejtësisë dhe barazisë. Po ashtu, brenda datës 31 mars të çdo viti, Ministri i Drejtësisë i paraqet, në emër të Këshillit të Ministrave, rekomandimet përkatëse Prokurorit të Përgjithshëm për luftën kundër kriminalitetit.

Sipas Kushtetutës, Ministri i Drejtësisë është përfaqësuesi i vetëm i Këshillit të Ministrave, anëtar i KLD-se. Po ashtu, Ministri i Drejtësisë ka të drejtë të fillojë inspektime ndaj gjyqtarëve, në rast ankimi ose mbi bazë tematike apo territoriale. Këto inspektime zhvillohen me iniciativën e tij ose në zbatim të detyrave të caktuara nga KLD.

2 Dokumenta strategjike të Ministrisë

Strategjia sektoriale e drejtësisë

Ministria e Drejtësisë ka përgatitur projektin fillestar të strategjisë sektoriale (strategji jo e plotë) të drejtësisë dhe ka siguruar komentet e ekspertëve të misionit Euralius të BE-së. Ky projekt së bashku me komentet e Euralius-it u është shpërndarë për mendim të gjitha drejtorive të përgjithshme në aparatin dhe institucionet e varësisë së saj. Priten kontributet e tyre për finalizimin e strategjisë.

Strategjia ndërsektoriale e të drejtave të pronës

Grupi ndërministror i punës në nivel zëvendësministrash, i ngritur me urdhër të Kryeministrit, së bashku me grupin ndërministror teknik të punës, ka përgatitur një projekt-strategji ndërsektoriale të të drejtave të pronës. Priten të sigurohen sugjerimet për përmirësimin e saj, për t'i reflektuar në versionin përfundimtar.

Qëllime

Politika e këtij sektori është hartuar për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të mëposhtme afatgjata:

- Harmonizimi dhe reformimi i legjisllacionit shqiptar, përmirësimi i shërbimeve të nevojshme lidhur me sistemin gjyqësor, sistemin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe shërbimeve të lira juridike
- Realizimi në mënyrë të drejtë dhe të shpejtë i procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve, duke synuar kthimin fizik të pronës në kufijtë maksimalë, aty ku është e mundur dhe, në pamundësi, kompensimin e saj sipas formave të përcaktuara në ligj.
- Publikimi i normave juridike dhe azhurnimi i legjisllacionit në një kohë sa më të shkurter nga data e miratimit të tyre në metoden klasike dhe elektronike. Përmirësimi i cilësive së ekspertimeve mjekoligjore duke u përafëruar me standartet metodike dhe tekniko-shkencore të instituteve analoge të Bashkimit Europian.
- Rritja e performancës së shërbimit të Permbarimit gjyqësor duke bërë të mundur; Zbatimin sa më korrekt të ligjit në trajtimin e gjithë kompleksitetit të çështjeve permbarimore; Respektimin e afateve ligjore për kryerjen e veprimeve proceduriale të përcaktuara për ekzekutimin e titujve të ndryshëm ekzekutiv.
- Profesionalizem në mënyrë që çiftet, familjet e ardheshme biresuese, të maturojnë një gadishmeri dhe aftësi reale për të zhvilluar burime të reja dhe për t'i bërë ballë problematikave tipike të biresimit. E gjitha kjo nepermjet një procesi që është i afte të nxjerr në pah emocionet dhe që të nxisë burime të reja dhe të pershtatshme prinderore.
- Përmirësimi i kushteve të jetesës së burgosurve dhe përmirësimin e trajtimit të tyre nga personeli i burgjeve, duke rritur elementet e sigurisë dhe duke u pershtatur plotësisht me konventat nderkombetare për respektimin e të drejtave të të denuarve.

3 Programet buxhetore të Ministrisë

3.1 PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

Politika e këtij programi konsiston në zhvillimin dhe rishikimin e strategjive dhe politikave të sistemit të drejtësisë; koordinimin dhe monitorimin e performances së programeve të ministrisë në mënyrë të veçantë për të promovuar përdorimin më efektiv të burimeve. Ai siguron mbështetjen menaxheriale dhe administrative për programet e tjera të ministrisë, veçanërisht në zhvillimin e vazhdueshëm të kapaciteteve menaxhuese të ministrisë. Gjithashtu pjesë e kësaj politike është edhe harmonizimi dhe reformimi i legjislacionit shqiptar, përmirësimi i shërbimeve të nevojshme lidhur me sistemin gjyqësor, sistemin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe shërbimeve të lira juridike.

3.2 PUBLIKIMET ZYRTARE

Politika e këtij programi konsiston në publikimin e normave juridike dhe azhurnimin e legjislacionit në një kohë sa më të shkurtër nga data e miratimit të tyre në metodën klasike dhe elektronike.

3.3 MJEKESIA LIGJORE

Politika e këtij programi konsiston në sigurimin dhe përshtatshmërinë në një kohë më të shpejtë të shërbimit mjeko-ligjor në të gjithë territorin e Republikës, në dobi të Gjykatës, Prokurorisë dhe Policisë. Kjo arrihet përmes përvetësimit të metodave të reja tekniko-shkencore, kualifikimeve të specialistëve, përmirësimit të kushteve në laboratorë dhe të pajisjes me aparatura të reja. Gjithashtu Përmirësimi i cilësisë së ekspertimeve mjeko-ligjore duke u përafruar me standardet metodike dhe tekniko-shkencore të instituteve analoge të Bashkimit Evropian është pjesë e qëllimit të këtij programi.

3.4 SISTEMI I BURGJEVE

Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin e sigurisë dhe jetesës së të dënuarve, rehabilitimin e tyre, dhe ngritjen profesionale të personelit të burgjeve.

3.5 SHERBIMI I PERMBARIMIT GJYQESOR

Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor nëpërmjet kompletimit dhe fuqizimit të infrastrukturës, logjistikës dhe rritjes profesionale të punonjësve. Ky program ka për qëllim rritjen e performancës së shërbimit të përmbarimit gjyqësor duke bërë të mundur zbatimin sa më korrekt të ligjit në trajtimin e gjithë kompleksitetit të çështjeve përmbarimore si dhe zbatimin e akteve ligjore.

3.6 SHERBIME PER ÇESHTJET E BIRESIMIT

Politika e këtij programi konsiston në faktin se birësimi si shërbim synon mirëqenien e të miturve për tu rritur në një mjedis familjar që mundëson një zhvillim të plotë dhe të harmonishëm të personalitetit të tyre. Përshtatja e një familje me një fëmijë, për të cilin është hartuar një plan birësimi kërkon një vlerësim objektiv të gjendjes psikosociale e emocionale të fëmijës dhe familjes birësuese. Domosdoshmëria e shtrirjes së shërbimeve psikosociale në nivele rajonale për rritjen e cilësisë së përzgjedhjes së familjeve për birësim.

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHEM

Politika e këtij programi konsiston në siguri më të lartë për regjistrimin dhe administrimin e titujve të pronësisë të cilët ruhen në ZRPP, rritjen e transparencës dhe përmirësimin e shërbimit dhe të komunikimit me qytetarët.

AGJENCIA E KTHIMIT DHE KOMPESIMIT TE PRONAVE

Politika e këtij programi ka në fokusin e saj subjektet e shpronësuara, të cilët janë persona fizikë, juridikë apo trashëgimtarët e tyre, prona e të cilëve është shtetëzuar, shpronësuar, konfiskuar ose marrë me çdo mënyrë tjetër të padrejtë nga Shteti. Objekti i veprimtarisë së AKKP-së është realizimi i së drejtës së pronësisë së subjekteve të shpronësuara, si një e drejtë themelore kushtetuese, e cila realizohet përmes procesit të kthimit dhe kompensimit të pronës. Politika e këtij programi konsiston në realizimi e një vendimmarrje sa më të drejtë dhe brenda afateve kohore që përcakton ligji, lidhur me kërkesat e subjekteve të shpronësuara për kthim apo kompensim të pronës.

4 Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2007

Sipas programeve, Ministria do të ofrojë produktet e mëposhtme në 2007. Këto produkte përbëjnë Planin e Monitorimit të Ministrisë.

4.1 PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

Objektivat e politikës

- Realizimi i perkthimeve në fushën e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar si dhe perkthimi i konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare trashëguar të paperkthyer nga vitet paraardhese.
- Permiresimi i funksionimit të sistemit të drejtësisë nëpërmjet rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të inspektimeve të sistemit gjyqësor dhe atij të prokurorisë.
- Reabilitimi i gjykatave të rrethëve gjyqësore Diber dhe Sarandë në kuadrin e projekteve CARDS 2005.
- Realizimi i ndërtimit dhe pajisja e Gjykatës së Krimeve të Rëndësishme në kuadrin e projekteve CARDS 2003 dhe CARDS 2004. Realizimi i ndërtimit të Institutit të Vuajtjes së Dënimit për të miturit në kuadrin e projekteve CARDS 2004. Instalimi i një strukture softëware në intranet dhe internet për Ministrinë e Drejtësisë. Kryerja e një studimi për matjen e efikasitetit të gjyqtarëve.
- Permiresimi i funksionimit të Komisionit të Reformës Ligjore.
- Trajnimi i stafit për zbatimin e standardeve të reja ligjore dhe institucionale.

Produktet që do të ofrohen

- Perkthime në fushën e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar.
- Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit të inspektimeve të sistemit gjyqësor dhe atij të prokurorisë.
- Akte ligjore, shërbime të sistemit gjyqësor, si dhe fushave të tjera të drejtësisë. Mirëfunksionimi i ministrisë së Drejtësisë.
- Mbeshtetje e MD në realizimin e projekteve të financuara me fonde të huaja (CARDS).
- Mbeshtetje e infrastruktures së sistemit të drejtësisë.
- Permiresim në hartimin e akteve ligjore.

4.2 PUBLIKIMET ZYRTARE

Objektivat e politikës

- Rritja e numrit të publikimeve zyrtare, publikimi i akteve në internet

Produktet që do të ofrohen

- Publikimi i fletorës zyrtare

4.3 MJEKESIA LIGJORE

Objektivat e politikës

- Permiresimi i kushteve të punës në sektorin e kryerjes së autopsive, përmes krijimit të një mjedisi të përshtatshëm të mbajtjes së kufomave në frigorifer me ngrirje të thellë.

Produktet që do të ofrohen

- Rritja e numrit, cilesise dhe llojshmerise se Akteve te ekspertimit.

4.4 SISTEMI I BURGJEVE

Objektivat e politikës

- Burgu 313: Permiresimi dhe zgjerimi i ambjenteve nepermjet rikonstruksionit te sistemit te ajrimit dhe tualeteve. Permiresimi i normes se te denuarve sipas studimit perkates. Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe i trajtimit ushqimor. Plotësimi i ambienteve me pajisje gazermimi, përmirësimi i pajisjeve të edukimit dhe të shëndetësisë.
- Burgu Rrogozhinë: Zgjerimi i ambjenteve
- Burgu Fushë Krujë: Venia ne efijence te plote
- Venia ne pune e paraburgimit te Durresit

Produktet që do të ofrohen

- Trajtimi i te denuarve sipas standarteve
- 2 ndertime te paraburgimit Durres dhe paraburgimit Elbasan
- Monitorimi i dosjeve te te denuarve, studim per punesimin e te denuarve si dhe mirefunksionimi i sistemit te burgjeve
- Paraprirje per mbipopullimin e te denuarve dhe te paraburgosurve ne burgje

4.5 SHERBIMI I PERMBARIMIT GJYQESOR

Objektivat e politikës

- Plotesimi i Sherbimit te Permbarimit Gjyqesor me ambjentet e nevojshme per 4 zyra permbarimi nepermjet kalimit kapital, Elbasan, Tirane, Kavaje, Pogradec.
- Realizimi dhe instalimi i nje software per lidhjen e Sherbimit permbarimor ne rrjet.
- Realizimi i nje trajnimi tre ditor per punonjesit e Sherbimit te Permbarimit Gjyqesor (punonjesit e zyrave ku do te instalohet software)

Produktet që do të ofrohen

- Ekzekutimi i titujve ekzekutive
- Permiresimi i kushteve te punes
- Kompletimi i Sherbimit e Permbarimit Gjyqesor me bazen logjistike te nevojshme

4.6 SHERBIME PER ÇESHTJET E BIRESIMIT

Objektivat e politikës

- Rritja kualitative e sherbimeve te Komitetit Shqiptar te Biresimit dhe afrimi i tyre me standartet me te perparuara.
- Krijimi i nje strukture me te plote te K.SH.B dhe i nje stafi me te kualifikuar profesionalisht, i afte ti pergjigjet kerkesave ne rritje ne drejtim te biresimit. Permiresimi i legjislacionit aktual ne drejtim te biresimeve kombetare dhe nderkombetare. Biresimi i femijeve me probleme dhe moshe te rritur.

Produktet që do të ofrohen

- Biresime te realizuara brenda dhe jashte vendit

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHEM

Objektivat e politikës

- Siguri me e larte per regjistrimin dhe administrimin e titujve te pronësise, rritje e transparencës dhe permiresim i sherbimit dhe komunikimit me qytetaret.

Produktet qe do te ofrohen

- Regjistrimi fillestar i 350 000 pasurive te paluajtshme ne 11 Zona Kadastrale ne qytetin e Tiranës dhe ne 3 Zona Kadastrale ne qytetin e Durrësit
- Azhornimi dhe permiresimi i informacionit ne leter dhe format dixhital per rreth 16,000 te tjera ne 11 Zona Kadastrale ne rrethin e Tiranës dhe 5 Zona Kadastrale ne rrethin e Durrësit
- Kontrolli sistematik tekniko-ligjor dhe i sherbimit ndaj qytetareve dhe i dokumentacionit per verifikimin e mbivendosjeve dhe veprimeve te paligjshme ne 10 Zyrtat Vendore me te medha te sistemit dhe cilesin e sherbimit ndaj qytetareve duke ndjekur rrjedhen e perpunimit te aplikimeve
- Rikonstruksioni i Zyres Tirane, Durrës, Vlore, Korçe
- Sigurimi i Zyrave te reja (blerje dhe ose marrja e objekteve publike/shtetërore dhe rikonstruksione) ne Lezhe, Kavaje, Elbasan, si dhe rikonstruksioni i disa zyrave te tjera
- Hapja e zyres se informacionit per ZVRPP Tirane dhe Zyren e Pritjes se Qytetareve per Zyren Qendrore
- Rishikimi i struktures dhe te limitit organik te numrit te punonjesve per te gjithë sistemin duke marre ne konsiderate volumin ne rritje te aktivitetit ne lidhje me qytetaret, regjistrimin fillestar dhe Projektin per Administrimin dhe Menaxhimin e Tokës (me financim te Bankës Botërore), si dhe marrdheniet me institucionet, vecanerisht ALUIZNI dhe AKKP.
- Realizimi i kthimit te pergjigjeve te aplikimeve me poste
- Udhezimi i pergjithshem dhe regjistri elektronik per zbatimin e aplikimeve dhe ndjekjen e rrjedhes se perpunimit te kerkesave
- Hapja dhe venia ne funksionim e sporteleve per sherbimet ndaj biznesit duke filluar me Tiranën dhe ne te gjitha ato zyra te medha te cilat kane kushte per te vendosur sportele te vecanta per pritjen dhe trajtimin e aplikimeve te biznesit

AGJENCIA E KTHIMIT DHE KOMPESIMIT TE PRONAVE

Objektivat e politikës

- Një administratë e hapur, që ofron pritjen dhe këshillimin e subjekteve të shpronësuar, duke i dhënë atyre të drejtën që të marrin pjesë në procedurën administrative përkatëse.
- Vendime të drejta dhe të mbështetura në ligj dhe akte nënligjore, të marra brenda afateve ligjore.
- Kompensimi i pronarëve të shpronësuar në të gjithë territorin e vendit.

Produktet qe do te ofrohen

- Shqyrtimi dhe marrja e vendimit lidhur me të gjitha kërkesat ankimore, të paraqitura nga subjektet e shpronësuar, të mbartura nga Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, brenda një periudhe të shkurtër kohore.
- Marrja e vendimeve për kthimin apo kompensimin e pronës, të bazuara në ligj, brenda afateve ligjore, duke ndikuar në rritjen e besimit të subjekteve të shpronësuar te Shteti.

- Bashkëpunim më efikas me institucionet shtetërore që kanë në administrim pronën shtetërore apo publike dhe që mbartin detyrimin ligjor që të japin informacionin e nevojshëm lidhur me të.
- Realizimi i hartës së vlerës së tokës për gjithë territorin e vendit.
- Digjitalizimi i arkivave dhe i hartave të pronave të shpronësuara, objekt i kthim/kompensimit.
- Realizimi i hartës së pronave shtetërore, objekt i kompensimit të subjekteve të shpronësuar.

Tabela Buxheti 2007 sipas programeve dhe llojeve te shpenzimeve, million Lek

Programet	Pagat dhe kontribute e sigurimeve shoqerore 600, 601	Mallra dhe sherbime 602	Subveconet 603	Te tjera transferte korrente 604, 605	Transferta per buxhetet familiare dhe individet 606	Shpenzime kapitale 230, 231	Total
Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	122	51	0	1	0	779	954
Publikimet zyrtare	21	19	0	0	0	94	135
Mjekesia ligjore	29	11	0	0	0	25	65
Sistemi i burgjeve	1 753	574	0	0	0	1 212	3 540
Sherbimi i permbarimit gjyqesor	137	30	0	0	0	10	177
Sherbimet per ceshtjet e biresimeve	6	5	0	0	0	0	12
Total, Ministria e Drejtësisë	2 070	690	0	1	0	2 122	4 884
Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshëm	297	83	0	0	0	333	713
Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	141	29	0	0	500	5	675

5 Plani i Monitorimit të Ministrisë

Treguesit	Njësia	Qëllimi
Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi		
Përfundimi i studimit për matjen e efikasitetit të gjyqtareve		4
Numri i konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara		2
Numri i gjykatave që do rikonstruktohen		100
Numri i njerëzve të trajnuar për zbatimin e standardeve të reja ligjore dhe institucionale		
Gjykata e Krimeve të Rënda e ndërtuar dhe e plotësuar me pajisje		
Publikimet zyrtare		
Publikimi i fletores zyrtare		
Sistemi i burgjeve		
Burgu 313: Permiresimi dhe zgjerimi i ambjentëve nepermjet rikonstruksionit te sistemit te ajrimit dhe tualeteve.		
Burgu 313: Përmirësimi i pajisjeve të edukimit dhe të shëndetësisë		
Burgu Rrogozhinë: Zgjerimi i ambjentëve		
Paraburgimi i Durrësit: Venia ne pune		
Permiresimi i normes se te denuarve sipas studimit perkates		
Përfundimi i ndërtimeve në institucionet e paraburgimit në Durrës dhe Elbasan		
Sherbimi i permbarimit gjyqësor		
Plotesimi i Sherbimit te Permbarimit Gjyqësor me ambjentet e nevojshme per 4 zyra permbarimi nepermjet kalimit kapital, Elbasan, Tirane, Kavaje, Pogradec		
Realizimi dhe instalimi i nje software per lidhjen e Sherbimit permbarimor ne rrjet		
Numri i zyrave të Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor në vend		4
Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshëm		
Numri i pasurive të paluajtshme të regjistruar në 11 Zona Kadastrale në qytetin e Tiranës dhe në 3 Zona Kadastrale në qytetin e Durrësit		
Regjistri elektronik për zbatimin e aplikimeve dhe ndjekjen e rrjedhës së përpunimit të kërkesave		
Hapja dhe venia në funksionim e sporteve për shërbimet ndaj biznesit duke filluar me Tiranën		
Rikonstruksioni i Zyres Tirane, Durres, Vlore, Korce		
Sigurimi i Zyrave të reja (blerje dhe ose marrja e objekteve publike/shtetërore dhe rikonstruksione) në Lezhë, Kavaje, Elbasan		
Hapja e zyres së informacionit për ZVRPP Tirane dhe Zyren e Pritjes së Qytetareve për Zyren Qendrore		
Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave		
Shqyrtimi dhe marrja e vendimit lidhur me të gjitha kërkesat ankimore, të paraqitura nga subjektet e shpronësuar		
Marrja e vendimeve për kthimin apo kompensimin e pronës, të bazuara në ligj, brenda afateve ligjore, duke ndikuar në rritjen e besimit të subjekteve të shpronësuar të Shteti		
Realizimi i hartës së vlerës së tokës për gjithë territorin e vendit		
Digjitalizimi i arkivave dhe i hartave të pronave të shpronësuar, objekt i kthim/kompensimit		
Realizimi i hartës së pronave shtetërore, objekt i kompensimit të subjekteve të shpronësuar		

Aneks 1 Projekt-ligjet për tu paraqitur

Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi

- Projekt-ligj për disa shtesa dhe ndryshime ne K.Pr. Civile
- Ratifikimi i dy protokolleve shtese te Paktit Ndërkombëtar per te drejtat civile dhe politike
- Projekt-ligj për amendimin e Kodit Penal Ushtarak
- Projekt-ligj "Mbi disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr 8331, date 21.04.1998 "Per ekzekutimin e vendimeve penale"
- Projekt-ligj "Për ratifikimin e Konventës se Hagës "Për aksesin ndërkombëtar ne drejtësi" e 25 Tetorit 1980
- Projekt-ligj për ratifikimin e e Konventës se KE për mos zbatueshmërinë e legjislacionit te brendshëm për krime kundër njerëzimit
- Projekt-ligj "Mbi disa ndryshime e shtesa ne ligjin nr. 8328, datë 16.04.1998 "Për te drejtat edhe trajtimin e te dënuarve me burgim"
- Projekt-ligj "Për ratifikimin e Konventës se Hagës "Mbi procedurën civile" e 1 Marsit 1954
- Projekt-ligj "Për Administratën Gjyqësore"
- Projekt-ligj "Për ekzekutimin e alternativave te dënimit me burgim"
- Projekt-ligj "Për te drejtën ndërkombëtare private"
- Projekt-ligj "Për ratifikimin e Konventës se Hagës " Mbi njohjen dhe zbatimin e vendimeve te huaja për çështjet civile dhe tregtare" e 1 Shkurtit 1971 Lugano
- Projektvendim per zhvillimin e aktivitetit te punës ne burgje dhe shpërblimin e saj
- Ndryshime ne Ligjin Nr. 8678, date 14.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë se Drejtësisë"
- Hartimi i Rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë se Inspektimit ne Ministrinë e Drejtësisë"
- Projekt-ligj "Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor ne Republikën e Shqipërisë"
- Ndryshime ne Ligjin Nr. 8737, date 12.02.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë ne Republikën e Shqipërisë"
- Ndryshime ne Ligjin Nr. 8811, date 17.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit te Larte te Drejtësisë"
- Hartimi i paketës ligjore për funksionimin dhe rregullimin e gjykatave administrative, sipas Kuvendit

Minoritetet

- Parashikimi si figurë krimi të veçantë në Kodin Penal i krimeve për motive racore apo motive të tjera diskriminuese, ne përputhje me Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteve, si dhe konsiderimi si rrethanë rënduese në Kodin Penal i motivit diskriminues si motiv për kryerjen e veprës penale.

Profesionet e lira

- Projektakt nënligjor mbi njohjen reciproke te kualifikimeve te profesioneve te lira si avokat, noter, ekspert ligjor"

- Projektakt "Për heqjen e pengesave në qarkullimin e lire të personave dhe shërbimeve të shtetasve të Komunitetit Evropian në Shqipëri dhe anasjelltas"
- Ndryshime në ligjin nr. 9109, dt. 17.07.2003 "Për profesionin e avokatit në RSH"
- Projektakt nënligjor për ekuivalimin e shërbimeve të kryera nga noterët e Shqipërisë dhe atyre të komuniteti

Bashkëpunimi gjyqësor ndërkombëtar

- Miratimi i Projek-ligjit të ri "Për Bashkëpunimin Gjyqësor në Fushën Penale"
- Nënshkrimi i Marrëveshjeve dypalëshe "Për bashkëpunim administrativ"
- Nënshkrimi i Marrëveshjes "Për Bashkëpunimin gjyqësor" me Eurojust
- Miratimi i Projek-ligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ndryshime në Kodin Penal",
- Miratimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit "Për bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar në fushën penale"

Mbrojtja e të dhënave

- Hartimi i një ligji të ri "Për mbrojtjen e të dhënave personale"

Sistemi i burgjeve

- Hartimi dhe miratimi i rregulloreve të reja për qendrat e veçanta të sistemit të paraburgimit që do të ngrihen në të gjithë vendin
- Miratimi i "Disa shtesave dhe ndryshime në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve"
- Miratimi i projekt-ligjit "Mbi disa ndryshime e shtesa në ligjin "Për Policinë e Burgjeve"
- Miratimi i projekt-rregulloreve "Për funksionimin e komisionit mbikëqyrës të ekzekutimit të vendimeve penale"

Shërbimi përmbarimor

- Miratimi i projekt-ligjit për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8730, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor"
- Miratimi i projekt-urdhrit "Mbi caktimin dhe aplikimin e tarifave të shkallëzuara të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor"
- Miratimi i projekt-ligjit "Mbi procedurat e zhvillimit të ankandit"
- Miratimi i projekt-urdhrit "Për ndarjen e të ardhurave, kriteret, procedurat e administrimit dhe shpërndarjen e tyre"
- Miratimi i një Akt-marrëveshjeje me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë Ndërtimore

Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

- Ndryshimi I VKM Nr.292, datë 24.04.2003 "Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 549 datë 26.8.1996 të Këshillit të Ministrave "Për caktimin e tarifave të shërbimit të Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme"

Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave

- Projekt-vendim “Për procedurat dhe afatet e komunikimit ndërmjet institucioneve shtetërore, gjatë procesit të njohjes, kthimit apo kompensimit të pronës”
- Projekt-vendim “Për miratimin e modelit për të drejtën e pronësisë subjekteve të shpronësuara, për njohjen, masën dhe mënyrën e kthimit ose të kompensimit të pronësisë”
- Projekt-vendim “Për procedurat e shpërndarjes së fondit të kompensimit fizik”
- Projekt-vendim “Për procedurat e shpërndarjes së fondit të kompensimit në të holla”
- Projekt-vendim “Për miratimin e çmimeve të trojeve dhe tokave, të përcaktuara në hartat përkatëse”

Aneks 2 Rezultate që lidhën me Programin e Qeverisë

Mazhoranca e re dhe qeveria e saj do të zbatojnë në gjerësi dhe thellësi reformat e sistemit të drejtësisë, të sugjeruara e të mbështetura nga partnerët ndërkombëtarë dhe në bashkëpunim e sipas roleve perkatese kushtetuese me Presidentin, Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe institucionet e tjera që përfshihen në ceshtjet e reformave dhe performancës së sistemit të drejtësisë. Komuniteti i gjyqtarëve dhe juristëve si dhe shoqëria civile do të jenë gjerësisht të përfshirë në këtë proces. Reformat në drejtësi do të synojnë të rikthejnë besimin e shqiptarëve në sistemin gjyqësor dhe në ndershmërinë e paanësive të vendimit gjyqësor. Reforma do të përqendrohet në drejtimet e mëposhtme prioritare:

- garantimi i pavaresisë reale të sistemit të drejtësisë nëpërmjet fuqizimit të institucioneve të vetëkontrollit dhe administrimit të gjyqësorit;
- forcimi i përgjegjshmërisë dhe ndershmërisë së vendimit gjyqësor nëpërmjet rritjes së transparencës dhe aksesit, publikimit të plotë të vendimeve gjyqësore, përmirësimit të sistemit të vlerësimit të performancës së gjyqtarëve dhe të përgjegjshmërisë së tyre para ligjit bazuar në kritere objektive;
- përmirësimi i kushteve dhe mjeteve të gjyqësorit, rritja e profesionalizmit të gjyqtarëve, si dhe transparencës dhe objektivitetit në emërimet dhe karrierën e gjyqtarëve;
- zbatim të rigorozitetit dhe në çdo rast i vendimeve gjyqësore, në radhë të parë nga vetë institucionet shtetërore;
- nxitja e krijimit të formave të tjera alternative të gjyqimit si arbitrazhi dhe ndërmjetësimi;
- ristrukturimi dhe forcimi i kapaciteteve në institucionin e akuzës;
- ristrukturimi dhe forcimi i kapaciteteve të përmbartimit dhe hapja e mundësive për përmbartuesin privat në këto fushë;
- kthimi dhe kompensimi i pronave në kufijtë maksimalë të mundur, duke bërë kthimin fizik aty ku është e mundur, dhe në çdo rast tjetër kompensimin me vlerën e tregut, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004, "Për kthimin dhe kompensimin e Pronës", të ndryshuar;
- reformimi i sistemit të noterisë.

Në veçanti, përsa i përket sistemit të drejtësisë, tregues të matshëm do të jenë:

- harmonizimi i legjisllacionit shqiptar me standardet ndërkombëtare dhe komunitare
- drejtësi efciente
- transparencë me publikun
- saktësi dhe shpejtësi në procedim / informacion
- bashkëpunim intensiv ndërkombëtar
- krijimi i standardeve për kufizimin e krimit të organizuar
- ekzekutimi me sukses i titujve ekzekutivë në kohë dhe me cilësi
- profesionalizëm i stafit
- përafrimi me standardet evropiane të instituteve homologe të mjekësisë ligjore
- krijimi i kuadrit ligjor që do të përmbushë të gjitha kërkesat e një shërbimi cilësor
- krijimi i një shërbimi psiko-social sa më afër familjes
- rritja e sigurisë mbi titujt e pronësive dhe shpejtësisë së shërbimit për 50 % të pasurive në qytetin e Tiranës, dhe 75% e pasurive të paluajtshme në qytetin e Durrësit

Aneks 3 Rezultate që lidhën me integrimin European

Angazhimet në kuadër të Integritit European do të ndjekin prioritetet afatshkurtra sipas fushave të mëposhtme. Iniciativat ligjore dhe aktivitetet zbatuese të përcaktuara për periudhën afatshkurtër konsiderohen si angazhime që do të adresojnë në tërësi jo vetëm prioritetet afatshkurtra por dhe ato afatmesme.

Sistemi gjyqësor

Prioritetet afatshkurtra:

- Të rritet transparenca e proceseve penale dhe civile të drejtësisë;
- Të forcohet statusi, pavarësia dhe mbrojtja kushtetuese për gjyqtarët;
- Të vendosen rregulla objektive dhe transparente në caktimin e çështjeve që u ngarkohen gjyqtarëve;
- Të vendoset një sistem transparent meritash për vlerësimin e prokurorëve;
- Të përmirësohet bashkërendimi ndërmjet prokurorisë dhe policisë

Të drejtat e njeriut

Prioritetet afatshkurtra:

- Të respektohen konventat ndërkombëtare për ngritjen dhe drejtimin e institucioneve penitenciare;
- Të zbatohet master plani 2004 me qëllim përmirësimin e kushteve për të ndaluarit dhe të burgosurit në pritje të gjykimit;
- Të zbatohet me rigorozitet Kodi i Etikës për sistemin e burgjeve.
- Të arrihet një rritje e vazhdueshme në nivelin e ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore

Kthimi dhe kompensimi i pronave

Prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme:

- Përfundimi i procesit të kthimit të pronave deri me datë 30.06.2008.
- Zhvillimi i Strategjisë për tokën, përdorimin, tregun, administrimin dhe mbrojtjen e saj.
- Zbatimi i legjislacionit ekzistues për kthimin dhe kompensimin e pronave.
- Respektimi i masave në lidhje me klasifikimin e tokës
- Regjistrimi fillestar i pasurisë së paluajtshme si dhe digjitalizimi e përditësimi i informacionit lidhur me to.
- Përfundimi brenda datës 15 mars 2007, i procesit të verifikimit të kalimit në përdorim ose në pronësi pa kundërshtim të pasurisë së paluajtshme tokë, proces që do të realizohet nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në të gjithë territorin e vendit.

Merren në konsideratë të njëjtit tregues të matshëm të rezultateve sikurse treguesit e paraqitur në matjen e rezultateve të Programit të Qeverisë si më sipër.

Aneks 4 Rezultate që lidhën me anëtarisimin në NATO

Reforma e gjyqësorit

Reforma e gjyqësorit do të konsistojë kryesisht në zhvillimin e sistemit gjyqësor të pavarur dhe eficient, nëpërmjet rritjes së transparencës së proceseve penale dhe civile, eliminimit të vonesave në proceset gjyqësore, forcimit të statusit, pavarësisë dhe mbrojtjes kushtetuese për gjyqtarët, vendosjes së rregullave objektive dhe transparente në caktimin e çështjeve që u ngarkohen atyre dhe vendosjes së një sistemi eficient meritash për vlerësimin e prokurorëve.

Te drejtat e njeriut

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra në sistemin penitenciar do të ndërmerren iniciativat ligjore sic parashikohen në pjesën Iniciativat ligjore referuar më sipër në këtë dokument.

Ministria e Drejtësisë, Komisioni Evropian (Programi CARDS 2004), SIDA dhe UNICEF po vënë në jetë një program tre vjeçar për ngritjen e një sistemi drejtësie për të miturit të cilët janë në konflikt me ligjin, ndërkohë që po punohet për përfundimin sa më shpejt të paketës për drejtësinë penale për të miturit.

Bashkëpunimi gjyqësor ndërkombëtar

Për sa i përket bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar, përveç projektligjit për të drejtën ndërkombëtare private, i cili po hartohet dhe pritet të miratohet brenda gjashtëmuajorit të parë 2007, do të realizohen edhe këto masa të tjera ligjore sipas parashikimeve në iniciativat ligjore referuar më sipër në këtë dokument.

Në kuadrin e anëtarësimit të Shqipërisë në Konferencës e Hagës, nga ana jonë do të vazhdojë procesi i studimit dhe ratifikimit rast pas rasti i korpusit të konventave, veçanërisht të fushës së të drejtës ndërkombëtare civile, të tilla si Konventa e Hagës “Mbi procedurën civile”, Konventa “Për aksesin ndërkombëtar në drejtësi”, Konventa “Mbi njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja për çështjet civile dhe tregtare”, etj.

Merren në konsideratë të njëjtit tregues të matshëm të rezultateve sikurse treguesit e paraqitur në matjen e rezultateve të Programit të Qeverisë si më sipër.

Aneks 5 Investimet publike

Emërtimi i projektit	Kosto (në milion lekë)
Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	
Tarifa urbanistike ndaj bashkive për ndertimet e reja	4
EURALIUS Programi i asistencës teknike për sistemin e Drejtësisë	60
Trainimi i Administratës Gjyqësore	32
EURALIUS Programi i asistencës teknike për sistemin e Drejtësisë - Faza II	60
Trainimi i Administratës Gjyqësore - Faza II	32
Ndertimi Gjyqësor për Krimet e Renda	232
Ngritja e Gjyqësorëve të rejtë	25
Mbeshtetje për gjykatën dhe prokurorinë e Krimeve të Renda	124
Rinovimi i Gjykatave Diber dhe Sarandë	125
TVSH për mbulimin e investimeve të huaja	79
Publikimet zyrtare	
Mbeshtetje për QPZ	87
TVSH për mbulimin e investimeve të huaja	7
Mjekësia ligjore	
Pajisje blerje aparature për analizen e ADN	25
Sistemi i burgjeve	
Studim projektive	9
Rikonstruksione burgun e Peqinit	20
Ndertim puse uji në burgje	7
Ndertimi i paraburgimit Durrës	100
Ndertimi i paraburgimit Elbasan	150
Ndertime e rikonstruksione në burgun 313 Tiranë	40
Automjete për burgun e ri Fushe Krujë dhe paraburgimin Durrës dhe Elbasan	47
Pajisje për Policinë	34
Pajisje ndërlidhje dhe për trajtimin e të burgosurve	24
Trainimi i stafit të burgjeve	62
Ndertimi i Institutit Vuajtës Dënimit për të Mitur, Kavajë	211
Ndertimi i paraburgimit Vlorë	248
Ndertimi i burgut Korce	186
TVSH për mbulimin e investimeve të huaja	76
Sherbimi i permbarimit gjyqësor	
Rikonstruksion zyres permbarimit Durrës	7
Rikonstruksion zyres permbarimit Tiranë për ambientet e reja	3
Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshëm	
Blerje pajisje kompjuterike etj./ ZRPP	4
Blerje pajisje zyrash për ZVRPP- të	5
Rikonstruksion ambjentëve të jashtëm të ZQRPP (zyra e pritjes), garazhet	11
Rikonstruksion ZVRPP Mallakastër	5
Rikonstruksion ZVRPP Lushnjë	5
Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	
Blerje e pajisjeve topografike, të zyrës e të tjera	5

Aneks 6 Projekte të ndihmës së huaj

Ministria e Drejtësisë disponon Masterplanin e Infrastrukturës Gjyqësore, një projekt i financuar nga BE, në kuadër të programit PHARE, me vlerë 700.000 Euro, me anë të së cilit është kryer identifikimi i të gjitha nevojave fizike në gjykatat shqiptare përfshi pajisjet dhe informatizimin për një periudhë zhvillimi 15 vjeçare. Realizimi i këtij projekti ka synuar që Ministria e Drejtësisë të ketë një plan real dhe të besueshëm të ndihmës për investime që kërkohen të bëhen për përmirësimin e infrastrukturës në sistemin gjyqësor si dhe të bëjë të mundur thithjen e investimeve, si nga buxheti i shtetit ashtu dhe nga investitore të huaj. Gjithashtu disponon Masterplanin e paraburgimeve, projekt i financuar nga BE dhe realizuar nga Ministria e Drejtësisë e Austrisë. Aktualisht sistemi i drejtësisë përfiton nga këto projekte të BE:

Emri i projektit	Donatori	Kosto totale (€ milion)	Statusi
Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi - Sistemi gjyqësor			
Misioni Euralius	CARDS 2002	4,5	ne zbatim
Trajnime dhe pajisje gjyqësor	CARDS 2003	1,5	ne zbatim
Gjykata e krimeve të renda	CARDS 2003	5,0	ne zbatim
Instituti i të miturve	CARDS 2004	1,5	ne zbatim
Gjykata tregtare	CARDS 2004	1,0	per tu filluar
Mbeshtetje prokurorise dhe Gjykates se Krimeve te Renda	CARDS 2004	2,4	per tu filluar
Mbeshtetje KLD	CARDS 2004	0,6	ne proces
Mbeshtetje QPZ	CARDS 2004	0,9	ne proces
Gjykata e Sarandes dhe Dibres	CARDS 2002-2004-2005	1,3	ne proces
Sistemi i burgjeve			
Burgu Korce faza e pare	CARDS 2002	2,5	ne zbatim
Burgu Korce faza e dyte	CARDS 2004	2,5	ne zbatim
Trajnime staf i burgjeve	CARDS 2004	0,5	ne zbatim
Instituti i të Miturve	CARDS 2004	1,5	ne zbatim
Parburgimi Vlore	CARDS 2002-2004-2005	4,4	ne zbatim

Bashkëpunimi i Zyres së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshëm me Bankën Botërore është zyrtarizuar me miratimin në qershor 2006 të një projekti kredie prej rreth \$25 milion. Politika e zhvillimit afatgjatë me anë të së cilës synohet të arrihet qëllimi i ZRPP, për një shërbim të përmirësuar, efience dhe transparence në sistemin e regjistrimit të pasurive si dhe përfundimin e regjistrimit fillestar, do të zhvillohet në 3 faze.

- Faza e parë (2007-2010) do të mbulojë të gjithë vendin por duke u përqendruar fillimisht në zonat urbane dhe periurban. Gjate kësaj faze do të synohet të bëhet regjistrimi fillestar i rreth 500 000 pasurive kryesisht në zonat urbane, si dhe automatizimi i shërbimit në 10 zyrat më të mëdha të vendit. Kosto për këtë fazë është llogaritur në rreth \$24 milion, burim i financimit për të cilat do të jete kryesisht Banka Botërore dhe pjesërisht buxheti i shtetit.
- Faza e dytë (2010-2013) do të përqendrohet në regjistrimin e pyjeve e kullotave dhe pjesë të tjera urbane duke synuar regjistrimin fillestar masiv të rreth 500 000 pasurive si dhe automatizimin e shërbimit në 10 zyrat të tjera. Kosto e përafërt e vlerësuar është rreth \$20 milion nga të cilat \$10 milion do të financohen nga buxheti i shtetit.
- Faza e tretë (2013-2016) do të mbulojë të gjitha ato zona të cilat nuk kanë qene subjekt i fazave të mëparshme duke synuar regjistrimin e rreth 200 000 pasurive dhe përditësimin digjital të ndryshimeve e transaksioneve në të gjithë vendin. Kosto e përafërt vlerësohet rreth \$10 milion, burimi i financimit për të cilat nuk është përcaktuar.

